



FEMA



Lartësitë e këshillueshme bazë për përmbytjet (ABFE) për Uraganin Sandy

Ndërsa komunitetet marrin veten nga efektet shkatërruese të Uraganit Sandy, është e rëndësishme që të nxirren mësim dhe të vihen në jetë masa zbutëse që sigurojnë ndërtime më të forta, më të sigurta dhe më pak të prekshme nga përmbytjet e ardhshme.

Përpara Uraganit Sandy, Agjencia Federale e Menaxhimit të Emergjencave (FEMA), si administruese e Programit Kombëtar të Sigurimit kundër Përmbytjeve (NFIP), ishte duke ri-studiuar zonat bregdetare të Nju Xhersit dhe Nju Jorkut për të përditësuar Hartat e Primeve të Sigurimit kundër Përmbytjeve (FIRM). Këto harta të përditësuar ishin caktuar t'u shpërndaheshin shteteve dhe zyrtarëve lokalë në mesin e vitit 2013. Duke qenë se hartat ekzistuese të primeve të sigurimit kundër përmbytjeve për këto zona janë hartuar më shumë se 25 vjet më parë, dhe duke qenë se hartat e përditësuar nuk janë finalizuar ende, është thelbësore që të jepen Lartësitë afatshkurtra të Këshillueshme Bazë për Përmbytjet (ABFE) për të mbështetur përpjekjet e rindërtimit.

Lartësitë e këshillueshme bazë për përmbytjet bazohen në shkencën dhe inxhinierinë sonare, dhe janë rezultat i të dhënave më të fundit dhe metodologjive të përmirësuar të studimit krahasuar me hartat ekzistuese. Bazuar në një vlerësim pas ngjarjeve të stuhive të fundit, duke përfshirë edhe Uraganin Sandy, FEMA ka përcaktuar se lartësitë bazë të përmbytjeve që shfaqen në disa harta të primeve të sigurimit kundër përmbytjeve nuk reflektojnë si duhet rrezikshmërinë e rrezikut aktual të përmbytjes në zona bregdetare. Në shumicën e rasteve, lartësitë e këshillueshme bazë për përmbytjet reflektojnë një nivel më të lartë përmbytjeje sesa hartat aktuale rregullatore. Zotëruesit e pronave dhe bizneseve duhet të konsultohen me zyrtarin lokal për ndërtimet për të kuptuar plotësisht kërkesat për përdorimin e lartësive të këshillueshme bazë për përmbytjet në përpjekjet e tyre për rindërtim.

Lartësitë afatshkurtra të këshillueshme bazë për përmbytjet (ABFE) do të vihen në dispozicion të komuniteteve në zonat e mëposhtme:

- **Kontetë e Nju Xhersit:** Atlantic, Bergen, Burlington, Cape May, Essex, Hudson, Middlesex, Monmouth, Ocean dhe Union.
- **Kontetë e Nju Jorkut:** Bronx, Kings, New York, Richmond, Queens dhe Westchester.


Burimet e disponueshme

- Për informacion mbi Ndhimën për Uraganin Sandy, vizitoni: www.fema.gov/sandy
- Për të aplikuar për ndihmën për raste katastrofe, vizitoni: <http://www.disasterassistance.gov/>
- Më shumë informacion mbi lartësitë e këshillueshme bazë për përmbytjet do të vihet në dispozicion në dhjetor 2012 në uebsajtin Region II Coastal të FEMA, vizitoni: www.Region2Coastal.com
- Për të drejtuar pyetje dhe për të marrë informacion mbi sigurimin kundër përmbytjeve, si edhe informacion të përgjithshëm mbi lartësitë e këshillueshme bazë për përmbytjet, telefononi Qendrën e Ndhimës të Programit Kombëtar të Sigurimit kundër Përmbytjeve në numrin 1-800-427-4661
- Për të mësuar se si të ndërtoni ndërtesa më të forta dhe më të sigurta, dhe të ulni potencialisht primet e sigurimit kundër përmbytjeve, shkarkoni fletën prezantuese të të dhënave *FEMA Building Science Resources to Assist with Reconstruction After Hurricane Sandy* (Burime të shkencës së ndërtimit nga FEMA për të ndihmuar me rindërtimin pas Uraganit Sandy) duke vizituar <http://www.fema.gov/library/viewRecord.do?id=6651>
- Për të parë nëse keni të drejtën të merrni grante dhe kredi për uljen e rrezikut, vizitoni: www.fema.gov/hazard-mitigation-assistance
- Për të mësuar më shumë mbi Programin Kombëtar të Sigurimit kundër Përmbytjeve ose për të gjetur një agjent të sigurimeve, vizitoni: www.FloodSmart.gov ose telefononi 1-888-229-0437
- Për informacion mbi rregulloren lokale të ndërtimit dhe kërkesat për leje ndërtimi, kontaktoni me autoritetet e komunitetit tuaj

Shtresat e të dhënave gjeospaciale dhe hartat për këto zona do të vihen në dispozicion përmes uebsajtit Region II Coastal të FEMA, www.Region2Coastal.com, në dhjetor 2012. Ky informacion do të shoqërohet me udhëzime për t'i informuar zyrtarët federalë, të shtetit dhe ata lokalë si dhe për t'i ndihmuar ata të marrin vendime të mirinformuara mbi rindërtimin.

Lartësitë e këshillueshme bazë për përmbytjet (ABFE) u përdorën me sukses në përpjekjet e rindërtimit pas Uraganit Katrina (2005). Shumë komunitete në Louisiana dhe Mississippi aplikuan lartësitë e këshillueshme bazë për përmbytjet, gjë që bëri që pronarët e shtëpive dhe të bizneseve të rindërtonin ndërtime më lart dhe më të sigurta, dhe në disa raste sollën ulje të primeve të sigurimit kundër përmbytjeve për të siguruarit në zonat me rrezikshmëri të lartë.

Në Nju Xhersi dhe Nju Jork, zyrtarët federalë, të shtetit dhe ata lokalë, ndërtuesit, arkitektët, agjentët e sigurimeve, zotëruesit e pronave dhe shtëpive duhet të përdorin lartësitë e këshillueshme bazë për përmbytjet për të marrë vendime të mirinformuara për rindërtimin, si dhe për të ulur ndikimin në raste përmbytjesh të ardhshme. Ata që zgjedhin të mos përdorin lartësitë e këshillueshme bazë për përmbytjet do të humbin një mundësi të madhe për të ulur rrezikun e ardhshëm të përmbytjes. Gjithashtu, komunitetet që marrin pjesë në sistemin e vlerësimit të komunitetit të NFIP, mund të marrin kredit



Shembull i ABFE është vetëm për qëllim ilustrimi

për aplikimin e standardeve më të larta se kërkesat minimale të NFIP, që do të rezultojnë në ulje të primeve për të siguruarit në zonat me rrezikshmëri të lartë.

Personat e siguruar të NFIP duhet të jenë në dijeni gjithashtu për legjislacionin aktual që mund të ndikojë primet e ardhshme të sigurimit. Ligji i Reformës së Sigurimit kundër Përmbytjeve Biggert-Waters i vitit 2012 kërkon që NFIP të eliminojë subvencionet dhe uljet për primet e sigurimit kundër përmbytjes dhe të rrisë primet për të reflektuar rrezikshmërinë

aktuale të përmbytjes. Këto dispozita mund të kenë ndikim të konsiderueshëm në të ardhmen në primet e sigurimit për pronat që nuk janë në përputhje me kërkesat e NFIP, dhe pronat që nuk janë në përputhje me lartësitë e ardhshme të këshillueshme bazë do të pësojnë rritje të konsiderueshme të primeve.

Informacioni i përdorur për të hartuar lartësitë e këshillueshme bazë për përmbytjet do të jetë pjesë e asaj që përdoret për të përditësuar hartat e primeve të sigurimit kundër përmbytjeve. Çmimet e primeve të sigurimit nuk do të rriten, dhe nuk do të aplikohen kërkesat e detyrueshme të blerjes derisa lartësitë bazë të përmbytjeve të rishikuar t'u nënshtrohen analizave, komenteve dhe përshtatjeve nga qeveritë lokale. Komunitetet inkurajohen fort



që të përdorin lartësitë e këshilluara bazë të përmbytjeve për të ndërtuar ndërtesa më të forta, më të sigurta dhe më pak të prekshme

nga përmbytjet e ardhshme. Dhënia e të dhënave të besueshme dhe në kohë për rrezikun e përmbytjes është vetëm një prej mënyrave se si FEMA ndihmon vendimmarrësit të sigurohen që komunitetet bregdetare të Nju Jorkut dhe Nju Xhersit të jenë të mbrojtura më fort dhe me më shumë zgjuarsis kundër kësaj ngjarjeje shkatërruese.

Për informacion shtesë mbi lartësitë e këshillueshme bazë për përmbytjet (ABFE) ju lutemi vizitoni www.Region2Coastal.com në dhjetor 2012. Gjithashtu, do të jetë e rëndësishme që zotëruesit e pronave dhe bizneseve të bashkëpunojnë me zyrtarët e tyre lokalë për të kuptuar plotësisht kërkesat për përdorimin e lartësive të këshillueshme bazë për përmbytjet në rindërtime. Vendimet që marrin zotëruesit e pronave dhe bizneseve tani mund të ndihmojnë për një të ardhme më të sigurt dhe më të fortë për familjen ose biznesin e tyre.

Përpara se të ndërtojnë, zotëruesit e pronave dhe bizneseve duhet të konsultohen me zyrtarët e qeverisë lokale për të përcaktuar lartësitë e detyrueshme për shtëpinë ose ndërtesën e tyre.